



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 7 dhe 8 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e Pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer 15 Nr.400-33781 të datës 29.06.2017, Vendimit të Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Lipjanit 1Nr.400-38442 të datës 19.07.2017, Thirrjes publike për aplikim 12-320-25196 e datës 18.05.2017 si dhe Ri-shpalljes 12-320-38359 të datës 20.07.2017 , Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform Thirrjes publike për aplikim 12-320-25196 e datës 18.05.2017 dhe Ri-shpalljes 12-320-38359 të datës 20.07.2017 për ndarje të subvencioneve (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Pajtim Krasniqi, Inspektor i Bujqësisë, Kryesues
2. Afrim Sadiku, Shef i Sektorit për Bujqësi, anëtar
3. Shaban Syla , Shef i Sektorit për Buxhet dhe Financa, anëtar

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për fermerë, brenda afatit prej 20 dite pune pas përfundimit të afatit të Ri-shpalljes publike në pajtim me legjislacionin për financat publike, dispozitat e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, Thirrjes publike për aplikim 12-320-25196 e datës 18.05.2017, Ri-shpalljes 12-320-38359 të datës 20.07.2017 dhe legjislacionit në fuqi.

- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve të subvencioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.400-28139 i datës 31.05.2017 për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve për ndarje të subvencioneve.

1Nr. 400-28139/1

Lipjan, më 31.07.2017

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

